



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 1487 Prot.

Tiranë, më datë 12.10.2021

VENDIM
Nr. 602, datë 12.10.2021

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 12.10.2021:

VENDOSI:

- Miratimin e pjesshëm të projektit “Zgjerim i rrjetit të komunikimeve elektronike të Operatorit VODAFONE ALBANIA nëpërmjet shtimit të antenave për 4 stacione bazë të emërtuara: 1. 1344 HOTEL MONARC ; 2. 1398 KUKËS 2; 3. 1399 CASA ITALIA; 1015 ROGNER 1340 ROGNER”, me aplikues z. Luan Dibra, zhvillues Vodafone Albania;
 - Shtyrjen e vendimmarrjes për stacionin 1344 HOTEL MONARC. Të ripozicionohet antena, duke zvogëluar impaktin në lidhje me objektin pasuri kulturore “Ura e Tabakëve”.
 - Shtyrjen e vendimmarrjes për stacionet 1015 ROGNER dhe 1340 ROGNER. Të ripozicionohen antenat, duke zvogëluar impaktin në lidhje me në Qendrën Historike të Tiranës, shpallur me VKM Nr. 582, datë 03.10.2018 “Për deklarimin e Qendrës Historike të qytetit të Tiranës, për caktimin e Zonës Mbrojtëse të saj dhe miratimin e planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin”.
 - Miratimin e stacioneve 1398 KUKËS 2 dhe 1399 CASA ITALIA.
- Subjekti aplikues duhet të vijojë me procedurën ligjore për miratimin sipas legjislacionit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, për stacionet e miratuara;
- Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
- Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankimi në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Arta DOLLANI

